



VENDIM

Nr. 128 Datë 02.12.2011

**MBI
LIDHJEN E KONTRATËS TË NEGOCIUAR NGA SHOQËRIA CEZ
SHPËRNDARJA SH.A PËR PROKURIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË SISTEMIN E
SHPËRNDARJES PËR VITIN 2012**

Në mbështetje të nenin 9 të Ligjit nr. 9072 date 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, pikës 2.10 të Vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 42 date 25.05.2009 “Rregullat dhe procedurat standarte të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 02.12.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën e CEZ Shpërndarja sh.a si dhe relacionin e Drejtorive teknike në ERE,

Konstatoi se :

Pas shqyrtimit të procedurës së prokurimit të zhvilluar nga shoqëria CEZ Shpërndarja sh.a si dhe duke ju referuar Rregullave dhe procedurave standarte të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a, në procesin e negocimit, realizohet kushti i parashikuar në Rregulloren për procedurat standarte të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a në pikën 2.10, ku thuhet se ERE miraton lidhjen e kontratës me kusht që çmimi i pranuar në kontratë të jetë më i ulët se ai i ofertës së paraqitur në tenderin e anuluar përpara se të fillojë procedura me negocim.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të aprovoje lidhjen e kontratës së negociuar nga shoqëria CEZ Shpërndarja sh.a me shoqërinë EFT AG sipas profilit:

EFT AG

Periudha 1.1.2012 – 31.12.2012

Fuqia: 150 MW CBC 100 % nga EFT

Sasia: 1,317,600 MWh

Çmimi /njësi: **62.40** Euro/MWh

2. Ngarkohet CEZ Shpërndarje sh.a për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.